



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**LEGJISLATURA VI**  
***Sesioni pranveror***

**Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor**

Mbledhja nr. 34

Prishtinë, më 23.1.2019, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

**PROCESVERBAL**

Në mbledhje morën pjesë: Muharrem Nitaj, Besa Gaxherri, Lutfi Zharku, Andin Hoti, Salih Zyba, Salih Salihu dhe Danush Ademi.

Munguan: Ganimete Musliu, Liburn Aliu, Etem Arifi dhe Sërgjan Mitroviq.

Stafi mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi, **Muharrem Nitaj**, kryetar i Komisionit.

*Për këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:*

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të komisionit nga mbledhja e mbajtur më 18.12.2018;
3. Miratimi i Raportit të punës së Komisionit për vitin 2018;
4. Shqyrtimi i Draft Planit të punës së Komisionit për vitin 2019;
5. Konfirmimi për lexim të dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit;
6. Të ndryshme.

**1. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

**2. Miratimi i Procesverbalit të komisionit nga mbledhja e mbajtur më 18.12.2018;**

*Muharrem Nitaj, kryetar*, konstatoi se Komisioni me 6 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, pa vërejtje e miratoi procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 18.12.2018.

**3. Miratimi i Raportit të punës së Komisionit për vitin 2018;**

*Muharrem Nitaj, kryetar*, për raportin tha se ka qenë i përgatitur për mbledhjen e fundit të vitit 2018 dhe i paraqiti aktivitetet e realizuara: Komisioni mbajti 27 mbledhje të rregullta dhe 16 mbledhje të grupit të punës, formoi 10 grupe të punës, shqyrtoi 10 projektligje, 4 prej tyre janë

miratuar nga Kuvendi kurse 6 janë në procedurë. Komisioni ndërmori 2 nisma legislative, shqyrtoi 4 raporte të agjencive raportuese si dhe shqyrtoi 1 strategji dhe 1 plan të veprimit. Gjatë këtij viti janë miratuar ligje me rëndësi, siç janë: *Ligji për trajtimin e ndërtimeve pa leje; Ligji për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz; Ligji për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguri bërthamore dhe Ligji për Veprimtaritë hidrometeorologjike. Po ashtu, është miratuar edhe Strategjia shtetërore për ujëra 2017-2036.*

Në mbledhjet e Komisionit kanë raportuar, ministrat e resorëve përkatës për bujqësi e mjedis dhe udhëheqës të agjencive të pavarura.

Në fund, Nitaj tha se komisioni e ka përmbushur agjendën e vet dhe është i kënaqur me punën e bërë.

**Andin Hoti**, tha se pajtohet me raportin, por shtoi se do të ishte më mirë të shtohet edhe kush nga deputetët kanë marrë pjesë në grupet punuese.

**Besa Gaxherri**, tha se puna e komisionit është pasqyruar mirë në këtë raport dhe nuk ka vërejtje.

**Salih Zyba**, tha se pajtohet me raportin sepse është një përmbledhje e aktiviteteve të komisionit, por tha se nuk është i kënaqur me punën e komisionit. Ka pak aktivitete të realizuara dhe për këtë ai tha se do të abstenojë gjatë votimit.

**Salih Salihu**, tha se gjatë këtij viti ka munguar monitorimi i ligjeve, që është edhe obligim i jonë.

*Në fund të diskutimeve, Muharrem Nitaj, ftoi deputetët për votim dhe Komisioni me 6 vota për, asnjë kundër dhe 1 abstenim, nxori këtë:*

#### *Përfundim*

*Miratohet Raporti i punës së Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor, për vitin 2018.*

#### **4. Shqyrtimi i Draft Planit të punës së Komisionit për vitin 2019;**

**Muharrem Nitaj**, kryetar, e paraqiti Draft Planin e punës për vitin 2019, për të cilin tha se gjatë shqyrtimeve të mëvonshme, mund të ndryshojë sipas nevojave dhe prioriteteve. Në kuadër të aktiviteteve kryesore, tha se komisioni planifikon të shqyrtojë 21 projektligje, 6 projektligje të cilat janë në procedurën e shqyrtimit në Komision dhe 15 projektligje bazuar në Programin legjislativ të Qeverisë për vitin 2019. Komisioni planifikon mbikëqyrjen e zbatimit të 2 ligjeve, 1 nga fusha e bujqësisë dhe 1 nga fusha e mjedisit dhe planifikimit hapësinor, të cilat do të propozohen nga deputetët, si dhe do të shqyrtojë raportet vjetore të agjencive raportuese siç janë: Raporti vjetor i punës së Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2018; Raporti vjetor i Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit për vitin 2018; Raporti për gjendjen e mjedisit për vitin 2018. Ai propozoi që miratimi i tij të shtyhet për mbledhjen e radhës dhe deri atëherë të dërgohen propozimet nga të gjithë anëtarët e komisionit.

**Salih Zyba**, tha se pajtohet me shtyrjen e shqyrtimit të planit të punës, dhe propozoi që komisioni të bëjë sugjerime për zhvendosje të agjendës legislative. Zyba përmendi Projektligjin për farëra i planifikuar të procedohet në dhjetor dhe tha se duhet të kërkohet nga Qeveria të vijë më herët, për shkak të rëndësisë që ka, ndërsa kërkoi një bashkëpunim edhe me organizata të tjera për mbështetje të komisionit.

**Besa Gaxherri**, tha se shihet si plan ambicioz sepse e kam pasë thënë edhe në vitin 2018 e nuk është realizuar dhe u pajtua që shqyrtimi i planit të shtyhet për mbledhjen e radhës. Gjithashtu u pajtua që agjenda e projektligjeve të kërkohet të zhvendoset.

**Andin Hoti**, tha se agjenda legislative bëhet në bazë të agjendës së Qeverisë e jo nga organizatat e tjera, dhe miratimin mund ta shtyjme dhe të japim ide të tjera për plotësimin e planit.

**Salih Salihu**, tha se plani është ambicioz por të gjitha këto ligje varen nga Qeveria dhe ka nevojë të një rikonfigurimi të aspektit kohor të ligjeve, ndërsa pyeti se a mundet komisioni të ndryshojë këtë agjendë. Komisioni e ka të drejtën e angazhimit të ekspertizës nga jashtë për ligje të ndryshme, ndërsa ne duhet të jemi më aktivë dhe në kryerjen e punëve.

Për nismën legislative, për cilësinë e bukës, si kryesues i këtij grupi, tha se është angazhuar së bashku me Fakultetin e Bujqësisë në hulumtimin, për cilësinë e bukës në të gjithë Kosovën dhe tash janë krijuar kushtet që të ulemi si grup punues, në mënyrë që të përfundohet në sesionin pranveror.

Salihu, në fund shtroi nevojën e vizitave në vendet e rajonit, për të marrë përvojat e mira.

**Muharrem Nitaj**, kryetar, konstatoi se komisioni do ta shqyrtojë planin e punës për vitin 2019, në mbledhjen e radhës dhe deri atëherë kërkoi që të dërgohen propozimet nga të gjithë anëtarët e komisionit, propozim ky, më të cilin u pajtuan edhe anëtarët e tjerë.

## **5. Konfirmimi për lexim të dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit;**

**Muharrem Nitaj**, kryetar, tha se këtë projektligj komisioni në mbledhjen e mbajtur më 11.12.2018, e ka shqyrtuar, me ç'rast e ka miratuar një amendament dhe tash pas mendimit të komisioneve të përhershme, duhet të votohet dhe të përcillet për seancë në lexim të dytë.

Nitaj, shtoi se është takuar me drejtorin e Shoqatës së Ujësjellësit dhe Kanalizimit të Kosovës dhe ai e ka paraqitur si shqetësim saktësimin e mospagesës së objekteve të kultit për ujin e shpenzuar dhe pyeti, a mund ta korrigjojmë më shumë këtë amendament. Vërejtja kryesore e tyre është se kompanitë e ujësjellësit dëmtohen me vendimin për lirim nga pagesa të objekteve të kultit dhe ata dyshojnë se në objektet e kultit mund të hyjnë edhe objekte të tjera sepse nocioni "objekt kulti" nënkuptohet i gjithë kompleksi i një objekti, ndërsa ata kërkojnë që të shtohet, se kush duhet ta bëjë kompensimin.

**Lutfi Zharku**, propozoi të shtohet një paragraf i ri në amendament, që tregon se me udhëzim administrativ do të definohet çka është objekt i kultit dhe çka janë hapësirat tjera dhe pastaj Rregullatori i ujërave e përcaktojë në mënyrë të saktë, se çka lirohet, e çka jo nga pagesa.

**Salih Zyba**, tha se për lirim nga një kategori nga pagesa, dikush duhet ta marrë përgjegjësinë për kompensim, dhe të paktën të kenë njësi matëse, që të regjistrohet sasia e shpenzuar. Kemi kategori të ndryshme të shoqërisë që lirohen nga pagesa dhe përfaqësuesit e ndërmarrjeve të ujit kanë të drejtë në kërkesën e tyre sepse duhet të dihet se kush e ka përgjegjësinë e kompensimit të kësaj sasive të shpenzuar të ujit, e jo kjo të bëhet barrë buxhetore për ndërmarrjen.

**Besa Gaxherri**, tha se përfaqësuesit e ndërmarrjeve të ujit, kanë të drejtë për këtë shqetësim, se në objekte të kultit, uji shfrytëzohet pa kriter, Ajo e përkrahu propozimin e Lutfi Zharkut, që të definohet saktë në ligj, se çka nënkuptojmë me objekte të kultit dhe edhe ajo nëse lirohen nga pagesa, ata të kenë ujëmatësin. Gaxherri propozoi që përfaqësuesit që do të ftohen në mbledhje, të propozojnë konkretisht, si e mendojnë ata përkufizimin për këtë çështje?

**Andin Hoti**, tha se pajtohet që shpenzimi i ujit duhet të matet dhe dikush duhet atë ta paguaj, dhe nëse e paguan shteti, do të ketë më pak kontroll të shpenzimit të ujit.

**Salih Salihu**, tha se sasia e ujit që nuk faturohet, shpenzohet në mënyrë të pakontrolluar dhe shtoi se me drejtorin e ARRU-së, duhet të diskutojmë se, sa i duhet ujë një objekti të kultit për nevojat e veta dhe ajo ti lejohet, ndërsa, nëse e tejkalon kuotën, do ta paguan.

**Danush Ademi**, tha se kjo çështje duhet të definohet më mirë, fjala vjen një xhami në një fshat i shpenzon ndoshta 5 metra kub ujë, por një kishë, shembull ajo në Deçan, i harxhon 200, apo më

shumë kub ujë dhe këto duhet të definohen mirë sepse nuk janë shpenzimet e njëjta. Dhe kjo është pak problem përderisa të definohet dhe do të marrë kohë, e edhe ligji do të vonohet.

*Në fund Muharrem Nitaj, kryetar, konstatoi se Komisioni në mbledhjen radhës do ta diskutojë së bashku me drejtorin e ARRU-së dhe drejtorin e SHUKOS, për të sqaruar dhe gjetur një zgjidhje për këtë çështje.*

## **6. Të ndryshme.**

**Salih Zyba**, kërkoi të shqyrtohet një shkresë e ardhur nga Sindikata Punëtorëve të Pylltarisë në lidhje me pagat, dhe pas diskutimeve u vendos që t'i kthehet përgjigje me sugjerimin që kjo shkresë ti drejtohet Komisionit për Buxhet dhe atij të administratës publike.

**Besa Gaxherri**, paraqiti dy kërkesa të ardhura; një për importin e farërave të kungullit nga Austria, për problemin se në doganë në listën e farërave, nuk ekziston kodi i këtij lloji dhe kërkesa për importin e makinave bujqësore, si laktofrizit dhe rimorkios për shpërndarjen e plehut e për të cilat janë të detyruar të paguajnë tvsh-në dhe pyeti se çka mundemi si komision t'ju ndihmojmë këtyre fermerëve.

**Salih Salihu**, tha se këtë çështje e ka ngritur edhe me MBPZHR-në dhe është fjala për dëmtimin e fermerëve gjatë importit të rimorkios bujqësore, që është shpërndarës i plehut dhe ata detyrohen të paguajnë tvsh dhe doganë edhe pse është makinë bujqësore dhe laktofrizat për fermerët e qumështit, dhe vetëm pse e ka emrin “friz” detyrohen të paguajnë doganë dhe tvsh. Ndërsa për farërat, tha se ekziston lista nacionale e farërave dhe ky lloj i farës nuk ka kod të vetin dhe për këtë duhet biseduar me MBPZHR-në. Në fund, sugjeroi që kur të vijnë shkresat për farat e kungullit dhe importin e makinave bujqësore, pastaj komisioni ti drejtohet MBPZHR-së për këtë çështje.

**Salih Zyba**, paraqiti edhe një shqetësim në lidhje me zbatimin taksës për ndalimin e importit të produkteve nga Serbia dhe Bosnja, sidomos atyre bujqësore. Shkas për këtë, ai përmendi një kronikë të lajmeve, ku një zyrtari doganës thotë se “prej momentit të vendosjes së taksës, nuk ka pasur asnjë të hyrë doganore nga këto vende”, ndërsa gjendja në terren është ndryshe dhe nuk ka mungesë të produkteve dhe kjo është shqetësuese. Zyba kërkoi që komisioni ti drejtohet doganës me pyetje konkrete: *Prej momentit të hyrjes në fuqi të taksës e deri më sot, cilat janë të hyrat e doganës?* Por edhe ATK-së dhe AUV-it, nëse kanë edhe ata ndonjë shqetësim për këtë.

Në lidhje me këtë temë **Salih Salihu**, tha se çmimet e produkteve bujqësore, sidomos të drithërave misrit dhe të grurit nuk kanë lëvizur ashtu siç është pritur. Ato po hyjnë në Kosovë, sidomos nga Maqedonia dhe do të ishte mirë, t'i marrim të dhënat e doganës nga pikat doganore me Maqedoninë, se a ka pasur rritje të importit gjatë kësaj periudhe.

Në fund Muharrem Nitaj, kryetar, tha se posa të formulohet pyetja konkrete, shkresa do ti dërgohet në emër të komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 11:55.

E përgatiti:

*Stafi mbështetës i Komisionit.*

Kryetari i Komisionit,

**Muharrem Nitaj**